



Aldrin H. Dalipi është Kryetar i Qarkut dhe Këshillit Bashkiak të Tiranës.

Ai është i martuar me znj. Luljeta Anamali dhe kanë dy fëmijë: vajzën Enisën dhe djalin Aiden.

Pas përfundimit të studimeve në Shkollën e Mesme Artistike (në 1989) ai u diplomua (90-94) në Akademinë e Arteve (Menaxhim i Arteve) si dhe më pas në fushën e Drejtësisë (Jurist). Ka marrë pjesë në programe profesionale ndërkombëtare në fushën e komunikimit publik, gazetarisë si dhe administrimit të zgjedhjeve, në SHBA dhe vende të BE.

Ai iu bashkua lëvizjes studentore në 1990 si student i Arteve, me bashkëmoshatarët e vet, që ngritën zërin ndaj sistemit të diktaturës dhe besuan në vlerat më të mira europiane.

Ka nisur karrierën e tij në fushën e mësimdhënies për Artet në nivelin e shkollës së mesme rreth viteve 96-98 dhe më pas iu përkushtua fushës së gazetarisë dhe komunikimit publik. **Në vitin 1999, A.Dalipi punoi si gazetar i çështjeve politike dhe sociale në RTSH.**

Në vitin 2000-2002 punoi si Drejtor i Komunikimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë kësaj periudhe u zhvilluan zgjedhjet e vështira vendore të vitit 2000 dhe zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të vitit 2001, ku pavarësisht trysnisë së fortë dhe kontestimeve politike, fusha e komunikimit publik dhe transparenca me mediat u vlerësuan posaçërisht në raportet ndërkombëtare të asaj periudhe (raporti OSBE-ODIHR).

Nga viti 2002 deri në vitin 2005, Aldrin Dalipi punoi si Zëdhënës i Qeverisë Shqiptare dhe Kryeministrit, detyrë gjatë të cilës bëri përpjekje të forta për transparencë dhe komunikim të drejtë me mediat dhe publikun.

Pas shtatorit 2005, për vite me radhë, drejtoi media televizive (NEWS24) dhe agjenci lajmesh (BALKANWEB) deri në 2007, si dhe kontribuoi në vazhdim në fushën e marrëdhënieve publike në sipërmarrje të ndryshme.

Në Tetor 2009 iu besua drejtimi i gazetës së Partisë Socialiste, në atë periudhe në opozitë dhe në kushte të vështira për median e shkruar. Në Nëntor 2009, zgjidhet anëtar i Asamblesë Kombëtare të PS-së.

Në zgjedhjet vendore të vitit 2011, Aldrin Dalipi u zgjodh anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës, ku kryesoi grupin e këshilltarëve socialistë (në opozitë) në këtë këshill.

Në vitin 2013 u zgjodh Kryetar i Këshillit Bashkiak të Tiranës, me votat e shumicës së këtij Këshilli, deri në përfundim të mandatit në vitin 2015, periudhë gjatë të cilës krijoi bashkë me këshilltarë të tjerë Shoqatën e Këshilltarëve Bashkiakë të Shqipërisë. Këshilli Bashkiak i Tiranës, në drejtimin e tij, miratoi vendime të rëndësishme konsensuale përmes dialogut

politik të qëndrueshëm mes grupeve politike në këshill dhe komunikimit, në interes të qytetarëve.

Në Qershor të vitit 2015, me zhvillimin e zgjedhjeve vendore, Aldrin Dalipi zgjidhet anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës duke kryesuar listën e PS dhe rizgjidhet Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Ai drejton Qarkun Tiranë dhe në Dhjetor 2015 u votua nga Asambleja e AIE (Adriatic Ionian Euroregion) në Bruksel, si zv.President i Euro-Rajonit Adriatiko-Jonian, duke u përkushtuar për një dimension të rëndësishëm të zhvillimit rajonal (në qeverisjen vendore) përmes bashkëpunimit të ngushtë me gjithë rajonet e hapësirës Adriatiko- Joniane (Itali, Kroaci, Mal i Zi, Greqi, etj,) në frymën e integritimit në Bashkimin Europian. Nga viti 2016 është anëtar i Komitetit Politik të Rajoneve Periferike Detare të Europës (CPMR).